



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 28 maj 2018
Nr. ref.: RK 1234/18

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI98/17

Parashtrues

Sabit Veseli

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 61/17, të 20 prillit 2017

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Sabit Veseli, me vendbanim në Gjilan (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqëson Halit Azemi, avokat.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin [Pml. nr. 61/17] e 20 prillit 2017 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), përmes të cilit është konfirmuar Aktgjykimi [PAKr. nr. 703/16] i 27 janarit 2016 të Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimi [PKR. nr. 232/16] i 23 nëntorit 2016 të Gjykatës Themelore në Gjilan.
3. Aktgjykimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 5 maj 2017.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtës së tij të garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës], 47 [Kërkesa individuale], neni 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe neni 49 [Afatet] të Ligjit nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) si dhe në rregullin 29 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 18 gusht 2017, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 22 gusht 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Gresa Caka-Nimani gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.
8. Më 12 shtator 2017, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe një kopje të kërkesës ia dërgoi Gjykatës Supreme.
9. Më 19 prill 2018, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 13 shtator 2016, parashtruesi i kërkesës ishte ndaluar nga zyrtarët e policisë së Kosovës dhe gjatë kontrollit, në makinën e tij i është gjetur sasi e substancës narkotike. Me këtë rast, lënda narkotike është sekuestruar dhe parashtruesi i kërkesës është arrestuar.

11. Më 27 shtator 2016, Prokuroria Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda (në tekstin e mëtejme: Prokuroria Themelore në Gjilan) ngriti aktakuzë kundër parashtruesit të kërkesës, për shkak të dyshimit të bazuar për kryerjen e veprës penale nga paragrafi 2, lidhur me paragrafin 5, të nenit 273 (blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPRK).
12. Më 23 nëntor 2016, Gjykata Themelore në Gjilan, përmes Aktgjykimit [PKR. nr. 232/16] e shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës dhe e dënoi me burgim efektiv, në kohëzgjatje prej 4 (katër) vjetësh dhe me dënim me gjobë në shumë prej 2000 (dymijë) €, për shkak të kryerjes së veprës penale nga paragrafi 2, i nenit 273 të KPRK-së. Gjykata gjithashtu vendosi që parashtruesit të kërkesës t'i vazhdohet paraburgimi deri sa vendimi të marr formën e prerë, por jo më gjatë se masa e dënimit të shqiptuar.
13. Aktgjykimi i Gjykatës Themelore ishte bazuar në pranimin e fajësisë nga ana e parashtruesit të kërkesës, mbi bazën e të cilës Gjykata kishte nxjerrë aktvendim për pranimin e fajësisë.
14. Më 26 nëntor 2016, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit [PKR. nr. 232/16] të Gjykatës Themelore në Gjilan, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkelje të ligjit penal, dhe vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar të anulohet, duke e kthyer çështjen në rigjykim, ose që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet në favor të të dënuarit, përkatësisht parashtruesit të kërkesës, duke i shqiptuar dënim më të butë.
15. Esenca e ankesës së parashtruesit të kërkesës është ndërtuar mbi shkeljen e pretenduar të së drejtës së mbrojtjes gjatë procesit të pranimit të fajësisë dhe mosmarrjes parasysh nga ana e Gjykatës, të kundërshtimeve dhe kërkesës së mbrojtjes që vepra penale të rikualifikohet mbi bazën e nenit 275 (Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge) të KPRK-së, dhe jo mbi bazën e paragrafit 2 të nenit 273 (Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge) të KPRK-së.
16. Më 15 dhjetor 2016, Prokuroria Themelore në Gjilan, gjithashtu, ushtroi ankesë kundër Aktgjykimit [PKR. nr. 232/16] të Gjykatës Themelore në Gjilan sa i përket vendimit për sanksionin penal, duke propozuar që Aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të dënuarit, përkatësisht parashtruesit të kërkesës, t'i shqiptohet dënim më i ashpër me burgim.
17. Më 27 janar 2017, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [PAKr. nr. 703/16], refuzoi, si të pabazuar, ankesat e parashtruesit të kërkesës dhe të Prokurorisë, duke konfirmuar Aktgjykimin [PKR. nr. 232/16] e Gjykatës Themelore në Gjilan.
18. Më 24 shkurt 2017, parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit [PAKr. nr. 703/16] të Gjykatës së Apelit, duke u thirrur në shkelje të ligjit penal dhe në shkelje

esenciale të dispozitave të procedurës penale. Parashtruesi i kërkesës vazhdoi të kontestoi ligjshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, duke pretenduar sërish shkelje esenciale të procedurës penale sepse, sipas pretendimit të tij, e drejta e mbrojtjes së parashtruesit të kërkesës është shkelur gjatë pranimit të fajësisë, mbi bazën e të cilit parashtruesi i kërkesës është shpallur fajtor.

19. Më 20 prill 2017, Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit [Pml. nr. 61/17], e refuzoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë dhe konfirmoi Aktgjykimin [PAKr. nr. 703/16] të 27 janarit 2017 të Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimin [PKR. nr. 232/16] të 23 nëntorit 2016 të Gjykatës Themelore në Gjilan.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me aktgjykimin e kontestuar, Gjykata Supreme shkeli të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës.
21. Më specifikisht, parashtruesi i kërkesës pretendon që aktgjykimi i kontestuar është nxjerrë në shkelje të dispozitave të procedurës penale të përcaktuara me paragrafin 2, të nenit 384 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPPRK), në lidhje me nenet 326 dhe 248 të të njëjtit Kod, që rregullojnë procedurën e pranimit të fajësisë në shqyrtimin gjyqësor dhe shqyrtimin fillestar, respektivisht.
22. Parashtruesi i kërkesës, për më tepër, pretendon që Gjykata nuk mori parasysh mendimin e mbrojtjes dhe kundërshtimet e tij në lidhje me kualifikimin e veprës penale. Në këtë aspekt, parashtruesi i kërkesës pretendon që pranimi i fajësisë ishte bërë vetëm në rast të kualifikimit të veprës penale mbi bazën e nenit 275 (Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge) të KPRK-së, dhe jo mbi bazën e nenit 273 (Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge) të KPRK-së, siç ishte reflektuar në Aktvendimin e Gjykatës Themelore për pranimin e fajësisë.
23. Parashtruesi i kërkesës thekson se *“nuk e ka kuptuar rëndësinë e as pasojat e pranimit të fajësisë sepse është laik dhe ka qenë nën terapi mjekësore dhe kështu i është shkelur e drejta në mbrojtje”*, dhe për më tepër, sa i përket cilësimit të veprës penale, thekson se *“i akuzuari veprimet e veta i pranon por veprën penale me të cilën akuzohet nuk e pranon”*.
24. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon shpalljen të pavlefshme të Aktgjykimit [Pml. nr. 61/17] të 20 prillit 2017 të Gjykatës Supreme dhe kthimin e çështjes se tij në rigjykim.

Pranueshmëria e kërkesës

25. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të parapara më tej me Ligj dhe të përcaktuara me Rregullore të punës.

26. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

27. Gjykata gjithashtu vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç specifikohet më tej në Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

28. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në cilësinë e palës së autorizuar, duke e kontestuar një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [Pml. nr. 61/17] e 20 prillit 2017 të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Në këtë aspekt, kërkesa e parashtruesit është në përputhje me kriteret e përcaktuara me paragrafin 1 dhe 7, të nenit 113 të Kushtetutës dhe ato të nenit 47 të Ligjit. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka sqaruar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit, dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

29. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullin 36 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 36 (1) i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtojë kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Specifikisht, rregulli 36 përcakton që:

“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]

(d) kërkesa nuk arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]

(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose

[...]

(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

30. Gjykata, fillimisht rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon që me aktgjykimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 31 të Kushtetutës, për shkak se gjykatat e rregullta nuk morën parasysh mendimin e mbrojtjes, përkitazi me pranimin e fajësisë nga i akuzuari, përkatësisht parashtruesi i kërkesës.
31. Më specifikisht, parashtruesi i kërkesës pretendon që aktgjykimi i kontestuar është nxjerrë në shkelje të dispozitave të procedurës penale të përcaktuara me paragrafin 2, të nenit 384 të KPPRK-së, në lidhje me nenet 326 dhe 248 të të njëjtit Kod, që rregullojnë procedurën e pranimit të fajësisë në shqyrtimin gjyqësor dhe shqyrtimin fillestar, respektivisht. Parashtruesi i kërkesës, për më tepër, pretendon që gjykatat nuk morën parasysh mendimin e mbrojtjes dhe kundërshtimet e tij rreth pranimit të fajësisë në lidhje me kualifikimin e veprës penale.
32. Në këtë aspekt, dhe fillimisht, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës e ndërtoi rastin e tij mbi baza ligjshmërie, përkatësisht mbi aplikimin dhe interpretimin e gabuar të KPRK-së dhe KPPRK-së. Gjykata rikujton se këto pretendime kanë të bëjnë me fushën e ligjshmërisë dhe si të tilla nuk bien nën juridiksionin e Gjykatës, dhe si rrjedhojë, në parim, nuk mund të shqyrtohen nga Gjykata. (Shih, rasti KI56/17, parashtruese e kërkesës *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 35).

33. Gjykata më tej thekson që pretendimet e parashtruesit të kërkesës, si të tilla, iu atribuohen shkeljeve të dispozitave të ligjit procedural, përkatësisht paragrafit 2, të nenit 384 në lidhje me paragrafin 2, të nenit 248 dhe paragrafin 2, të nenit 326 të KPPRK-së, që kanë të bëjnë me pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestar dhe shqyrtimin kryesor, nga i pandehuri, gjegjësisht i akuzuari dhe diskrecionin e gjyqtarit të rastit ose të kryetarit të trupit gjykues, për të kërkuar mendimin e Prokurorit të Shtetit, mbrojtësit dhe të dëmtuarit.
34. Gjykata thekson që “Pranimi i fajësisë gjatë shqyrtimit fillestar” i rregulluar me nenin 248 të KPPRK-së dhe “Pranimi i fajësisë nga i pandehuri në shqyrtim gjyqësor” i rregulluar me nenin 326 të KPPRK-së, i mundësojnë, por nuk e obligojnë gjyqtarin e vetëm ose kryetarin e trupit gjykues, të marrin mendimin e Prokurorit të Shtetit, të mbrojtësit dhe të dëmtuarit. Interpretimi dhe aplikimi i këtyre dispozitave në rastin e parashtruesit të kërkesës, ishte arsyetuar në mënyrë të detajuar në aktgjykimet përkatëse të Gjykatës Themelore, Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme.
35. Në këtë aspekt, Gjykata Themelore, në Aktgjykimin e saj [PKR. nr. 232/2016], ndër të tjera, kishte theksuar:

“Trupi gjykues, pas dëgjimit të palëve dhe të mbrojtësit të të akzuarit, ka marrë aktvendim për pranimin e fajësisë, ngase ka ardhur në përfundim se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë; se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, avokatin Halit Azemi; se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike. Trupi gjykues, ka konstatuar se i akuzuari Sabit Veseli, e kishte pranuar fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale edhe gjatë marrjes në pyetje nga ana e zyrtareve të Policisë së Kosovës, si dhe gjatë marrjes në pyetje në Prokurorinë Themelore në Gjilan.”

36. Gjykata e Apelit, në Aktgjykimin e saj [PAKr. nr. 703/2016], ndër të tjera, kishte theksuar:

“Mirëpo, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, pretendimet ankimore të cekura si më lart nuk qëndrojnë, ngase gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar dispozitat e nenit 326 të KPPK-së, përkitazi me pranimin e fajësisë dhe në rastin konkret edhe nga shkresat e lëndës, rezulton se në shqyrtimin gjyqësor i akuzuari në prezencën edhe të mbrojtësit të tij avokatit Halit Azemi, e pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës për çka përkitazi me këtë është pajtuar edhe trupi gjykues dhe se i akuzuari nuk ka paraqitur vërejtje sa i përket pranimin të fajësisë së të akzuarit për të gjitha pikat e akuzës, për çka edhe rrjedh se gjykata e shkallës së parë ka zbatuar drejtë dispozitat e nenit 326 lidhur me nenin 248 të KPPK-së dhe ka marrë aktgjykim të ligjshëm, pra në bazë të pranimin të fajësisë.”

37. Në fund, Gjykata Supreme, në Aktgjykimin e saj [Pml. nr. 61/2017], në adresimin e pretendimeve për shkelje të procedurës dhe të drejtës së mbrojtjes gjatë pranimin të fajësisë, ndër të tjera, kishte theksuar:

“Në këtë situatë, nuk është i bazuar pretendimi se të dënuarit i është shkelur e drejta në mbrojtje, se ka qenë laik, i sëmurë dhe se nuk e ka kuptuar rëndësinë dhe pasojat e pranimin të fajësisë. Përkundrazi, siç u tha më lart, i dënuari jo vetëm se e ka thënë të kundërtën, por ka shtuar se nuk është i sëmurë dhe se pranimin e fajësisë e ka bërë pas konsultimit me mbrojtësin e vet. Për më tepër, mbrojtësi i të dënuarit nuk e ka kundërshtuar pranimin e fajësisë por ka kundërshtuar vetëm cilësimin juridik të veprës penale. Së fundi, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar deklaratën e Prokurorit të Shtetit lidhur me pranimin e fajësisë dhe kundërshtimin e mbrojtësit të dënuarit për cilësimin juridik të veprës penale dhe lidhur me atë ka vendosur me aktvendim, gjatë shqyrtimit gjyqësor, për çka nuk është i bazuar pretendimi se këto janë anashkaluar dhe nuk janë marrë në konsideratë. Rrjedhimisht, këto pretendime për ekzistimin e shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale nuk janë të bazuara.”

38. Për më tepër, Gjykata vëren se pretendimet e parashtruesit të kërkesës rreth kualifikimit të gabuar të veprës penale për të cilën parashtruesi i kërkesës është shpallur fajtor, gjithashtu ishin marrë parasysh dhe adresuar nga gjykatat e rregullta.
39. Në këtë aspekt, Gjykata e Apelit në Aktgjykimin e saj [PAKr. nr. 703/2016], ndër të tjera, arsyetoi:

“Po ashtu, pretendimet e mbrojtësit të të akuzuarit se në rastin konkret bëhet fjalë për vepër penale nga neni 275 par. 1 të KPK-së, nuk qëndrojnë ngase, në bazë të provave dhe shkresave tjera në lëndë në këtë çështje penale juridike nuk bëhet fjalë vetëm për posedim të substancës narkotike, sikur që pretendon mbrojtësi i të akuzuarit, por, për veprime inkriminuese që përbëjnë elementet e veprës penale nga neni 273, par. 2 të KPK-së, ngase, fakti se nga i akuzuari është konfiskuar substanca narkotike dhe atë duke marrë parasysh vendin ku ka qenë e fshehur, pastaj sasinë e substancës narkotike e sidomos mënyrën e ndarjes në pjesë-pjesë dhe atë në qese të posaçme pra, të përgatitur edhe për shitje atëherë pa dyshim që bëhet fjalë për vepër penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par. 2 të KPK-së, prandaj, me të drejtë ka kolauduar gjykata e shkallës së parë, kur të akuzuarin e ka shpallur fajtor për vepër penale të përshkruar më detajisht si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.”

40. Ndërsa, Gjykata Supreme në Aktgjykimin e saj [Pml. nr. 61/2017], gjithashtu, ndër të tjera, arsyetoi:

“Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, ky pretendim, i formuluar në këtë mënyrë është i paqartë dhe i pabazuar; sepse elementet qenësore të veprës penale për të cilën i dënuari është shpallur fajtor, dallojnë nga ato të veprës penale nga neni 275. të KPK-së. Në rastin e parë inkriminohet (mes tjerash) transporti i paautorizuar i narkotikëve, me qëllim të shpërndarjes, shitjes ose ofrimit për shitje, ndërsa në rastin e dytë vepra penale kryhet me mbajtjen e paautorizuar të narkotikut (pa veprime tjera

dhe pa qëllim të shpërndarjes, shitjes ose ofrimit për shitje). Në rastin konkret, ky pretendim nuk është i bazuar sepse përveç se nuk është i argumentuar, i dënuari ka pranuar fajësinë për atë përshkrim të veprimeve inkriminuese që ka qenë në aktakuzë, pranimi i fajësisë nuk është kundërshtuar, është aprovuar nga gjykata duke respektuar dispozitat përkatëse ligjore dhe është i drejt vendimi i gjykatës së shkallës së parë dhe ai i shkallës së dytë lidhur me cilësimin juridik të veprës penale. Andaj, pretendimi për shkeljen e ligjit penal po ashtu nuk u aprovua.”

41. Duke u bazuar në këtë elaborim, Gjkata vlerëson që gjykatat e rregullta në mënyrë të detajuar kanë arsyetuar dhe në mënyrë specifike kanë adresuar të gjitha pretendimet e parashtruesit të kërkesës rreth shkeljeve esenciale të KPRK-së dhe KPPRK-së.
42. Për më tepër, Gjkata konsideron që, si parashtruesi i kërkesës po ashtu edhe mbrojtësi i tij kanë pasur mundësi që përgjatë gjithë procesit gjyqësorë t'i kundërshtojnë argumentet e pafavorshme dhe t'i përdorin ato në favorin e tyre para gjykatave të rregullta, ashtu siç kërkohet me garancitë e përfshira në nenin 31 të Kushtetutës.
43. Në këtë kontekst, Gjkata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar se procedurat në Gjykatën Supreme, apo në gjykatat e tjera të rregullta, kanë qenë të padrejta apo arbitrare, apo që të drejtat dhe liritë themelore të tij të mbrojtura me Kushtetutë dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ), janë shkelur, si rezultat i aplikimit apo interpretimit të pretenduar të gabuar të dispozitave të lartcekura të KPRK-së dhe KPPRK-së. Gjkata rithekson se mënyra e aplikimit dhe interpretimit të dispozitave të caktuara të KPPK-së dhe KPPRK-së në një rast konkret penal është çështje e ligjshmërisë. Parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur të dëshmojë asnjë çështje kushtetuese me argumentet e tij të paraqitura para kësaj Gjykate. (Shih, rasti KI56/17, parashtruese e kërkesës *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 36; rasti KI63/16, parashtrues i kërkesës *Astrit Pira*, Aktvendim për papranueshmëri, i 8 gushtit 2016, paragrafi 44; dhe shih, gjithashtu rastet KI150/15; KI161/15; KI162/15; KI14/16; KI19/16; KI60/16 dhe KI64/16, parashtrues të kërkesës *Arben Gjokaj*, *Hysni Hoxha*, *Driton Pruthi*, *Milazim Lushtaku*, *Esat Tahiri*, *Azem Duraku* dhe *Sami Lushtaku*, Aktvendim për papranueshmëri, i 15 nëntorit 2016, paragrafi 62).
44. Gjkata rithekson se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta me rastin e vlerësimit të provave ose aplikimit të ligjit (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Ajo vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjkata do të vepronte si gjykatë e “shkallës së katërt”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në të vërtetë është roli i gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale. (Shih, *mutatis mutandis*,

Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut rasti *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28).

45. Gjykata më tej vëren se parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e procedurës para gjykatave të rregullta, gjegjësisht me faktin se dënimi i shqiptuar ndaj tij nuk është zbutur më tutje dhe se ai do të ekzekutohet si i tillë. Megjithatë, pakënaqësia e parashtruesit të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. (shih, *mutatis mutandis*, rastin *Mezotur - Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005, paragrafi 21.; dhe shih, gjithashtu rastin KI56/17, parashtruese e kërkesës *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 42).
46. Si rezultat, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet se procedurat përkatëse në ndonjë mënyrë ishin të padrejta apo arbitrare dhe se me vendimin e kontestuar janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë dhe me KEDNJ. (Shih, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).
47. Prandaj, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit nuk i përmbush kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Rregulloren e punës, sepse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, duke marrë parasysh që faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese dhe që parashtruesi i kërkesës nuk dëshmon mjaftueshëm pretendimin e tij për shkelje kushtetuese.
48. Si përfundim, Gjykata konkludon se kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe, në pajtim me rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (b) e (d) të Rregullores së punës, ajo duhet të deklarohet e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113. 7 të Kushtetutës, të nenit 20 dhe 48 të Ligjit dhe të rregullave 36 (1) (d) dhe (2) (b) e (d), si dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 19 prill 2018, njëzëri

VENDOS


- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani




Arta Rama-Hajrizi